

Nr. Prot. 308 Dt 22/7/2011



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr 3 Datë 15./06/2011

**“Për
miratimin në parim të kërkesës, për përdorimit të rezervave ujore nga përrrenjtë
e Gurëz dhe Hijes me konçesion, për prodhim hidroenergjie rrethi Skrapar.**

Në mbështetje të neneve 8 dhe 16 të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” dhe vendimit nr. 3, datë 19.07.2002 të KKU “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Sekretariatit Teknik të KKU, Këshillavë të Baseneve Ujëmbledhëse dhe Agjensive të Ujit”, kreu III, pika 2.8 B ,Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman,

VENDOSI:

Miratimin në parim të kërkesës, për përdorimit të rezervave ujore nga përrrenjtë e Gurëz dhe Hijes me konçesion, për prodhim hidroenergjie rrethi Skrapar.

HEC DOBRENJ

Veprat e marjes të vendosen në keto kuota :

- a-Kuota e hyrjes në veprën e marjes Nr 1 h=980 m (abs)
- b-Kuota e hyrjes në veprën e marjes Nr 2 h=898 m (abs)
- c-Prurje mesatare QII=0.51 m³/sek

1-Sasia e ujit jepet për përdorim në perputhje me kërkesat në sezonin e vaditjes, rakorduar cdo vit me Bordin e Kullimit Berat.

2-Ngarkohet AUB Seman për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

**PËRGJEGJËSI AUB
SEMAN
Saimir HOXHAJ**



**KRYETARI I KBU
SEMAN
Bujan HASAJ**

